

E PËRDITËSUAR MË 26 MARS 2020

KËSHILLA PËR SHËNDETIN NGA FIP

**COVID-19:
UDHËZIME PËR FARMACISTËT DHE STAFIN E
FARMACISË**

FEDERATA FARMACEUTIKE NDËRKOMBËTARE

COVID-19: UDHËZIME PËR FARMACISTËT DHE STAFIN E FARMACISË

FIP do të përditësojë këtë udhëzues pasi të ketë në dispozicion më shumë informacione.

Tabela e përmbajtjes

Qëllimi i këtij dokumenti	Erro
r! Bookmark not defined.	
Përgjegjësite dhe roli i farmacive të rrjetit të hapur	Erro
r! Bookmark not defined.	
Përgjegjësitë dhe roli i farmacive spitalore	Erro
r! Bookmark not defined.	
Aktivitetet e farmacisë	Erro
r! Bookmark not defined.	
Stafi i farmacisë	Erro
r! Bookmark not defined.	
Veprimet dhe pajisjet e farmacisë : garantimi i sigurisë dhe vazhdimësisë së shërbimit	Erro
r! Bookmark not defined.	
Masat parandaluese	Erro
r! Bookmark not defined.	
Përdorimi i maskave: Rekomandime për stafin e farmacisë dhe popullatën	7
Këshilla për popullatën	Erro
r! Bookmark not defined.	
Rekomandime për pacientët e jashtëm	12
Veprimet e farmacive të rrjetit të hapur dhe këshillimi i pacientit	Erro
r! Bookmark not defined.	
Izolimi dhe referimi i pacientit	Erro
r! Bookmark not defined.	
Trajtimi në shtëpi për pacientët që kanë shenja të lehta dhe dyshohen se kanë COVID-19	Erro
r! Bookmark not defined.	
Testi diagnostikues për njerëzit e dyshuar me COVID-19	Erro
r! Bookmark not defined.	

Sigurimi dhe aksesimi i stokut të barnave dhe pajisjeve kryesore	Erro
r! Bookmark not defined.	
Menaxhimi i pastrimit dhe dezinfektimit	Erro
r! Bookmark not defined.	
Kontrolli i infeksionit : masa paraprake të tjera	Erro
r! Bookmark not defined.	
Kontrolli i infeksionit : larja dhe fërkimi i duarve	Erro
r! Bookmark not defined.	
Si të përgatisim produkte me bazë alkoli për dezinfektimin e duarve	Erro
r! Bookmark not defined.	
Farmacia si një burim informimi	Erro
r! Bookmark not defined.	
Adresimi i problemeve të udhëtimit	20
Bibliografia	22
SHTOJCA 1: Lista e barnave kryesore për trajtimin e COVID-19	Erro
r! Bookmark not defined.	
SHTOJCA 2: Lista e strukturave kryesore, pajisjeve dhe pajisjeve mbrojtëse personale për infeksionet me COVID-19	Erro
r! Bookmark not defined.	
SHTOJCA 3: Udhëzuesi i OBSH-së për formulimin e produkteve të ndryshme për duart	Erro
r! Bookmark not defined.	
SHTOJCA 4: Qëndrueshmëria e SARS-CoV-2 në aerosole dhe sipërfaqe të ndryshme, dhe lista e dezinfektuesëve për objektet që kontaminohen zakonisht	Erro
r! Bookmark not defined.	
Vlefshmëria	Erro
r! Bookmark not defined.	
Mirënjohje	Erro
r! Bookmark not defined.	

Qëllimi i këtij dokumenti

Që nga dhjetori i vitit 2019, shpërthimi i një koronavirusi të ri bëri që ai të përhapej në shumë vende dhe të shkaktojë mijëra raste infektimi apo vdekje. COVID-19 është sëmundja e shkakuar nga virusi i ri SARS-CoV-2. Shumica e njerëzve që janë të infektuar ndjejnë simptoma të lehta të problemeve të frymëmarrjes që zhduken vetë, por disa njerëz zhvillojnë sëmundje më të rënda, si pneumonia. Virus transmetohet përmes kontaktit me një person të infektuar ose përmes spërklave të frymëmarrjes kur një person i infektuar kollitet ose teshtin. Ekziston një rrezik më i lartë i infeksionit nëse keni qenë në një zonë ku virusi po përhapet, ose nëse keni qenë në kontakt të ngushtë me një person të infektuar me koronavirusin e ri. Ekziston gjithashtu një rrezik më i lartë nëse vuani tashmë nga komorbiditete.

Qëllimi i këtij dokumenti është të sigurojë informacione dhe udhëzime përkatëse për pandeminë e COVID-19 për farmacistët dhe stafin e farmacisë të kujdesit parësor (d.m.th. farmacitë e rrjetit të hapur dhe në mjediset spitalore).

Infeksionet me koronavirus mund të parandalohen dhe një shpërthim mund të ndalet nëpërmjet angazhimit aktiv të vendimmarrësve, profesionistëve të kujdesit shëndetësor, mediave dhe komunitetit. Kjo u demonstrua në shpërthimet e mëparshme të koronavirusit, siç ishte në 2003 me SARS-CoV (Sindromi i rëndë respirator akut Coronavirus) ose në 2012 me MERS-CoV (Sindromi respirator i Lindjes së Mesme Coronavirus). Ky dokument synon të ndihmojë farmacistët dhe stafin e farmacisë në parandalimin e përhapjes së sëmundjes dhe të kontribuojë në menaxhimin e saj efikas në sistemin e kujdesit shëndetësor.

Përgjegjësitë dhe roli i farmacive të rrjetit të hapur

Farmacitë e rrjetit të hapur në zonat e prekura dhe jo të prekura nga virusi janë pika e parë e kontaktit me sistemin shëndetësor për të gjithë njerëzit me probleme të lidhura me shëndetin ose që thjesht kanë nevojë për informacion dhe këshilla të besueshme.

Farmacistët e rrjetit të hapur kanë përgjegjësinë e përbashkët për:

- Sigurimin e ruajtjes dhe furnizimit me stokun e përshtatshëm, me produktet dhe pajisjet farmaceutike, të tilla si barna, maska, etj
- Informimi dhe edukimi i publikut
- Këshillimi
- Referenca
- Promovimi i parandalimit të sëmundjes
- Promovimi i kontrollit të infeksionit

Përveç funksionit të lidhur me COVID-19, farmacitë ofrojnë një shërbim publik thelbësor për tërë popullatën përmes furnizimit me barna dhe kujdes farmaceutik. Sigurimi i vazhdimësisë së këtyre shërbimeve është thelbësor.

Në disa vende, si p.sh. [France](#) dhe [Portugal](#), farmacistët kanë qenë të autorizuar të përsërisin shpërndarjen e barnave të përshkruara për pacientët kronik, për të zvogëluar nevojën për receta mjekësore dhe takimeve të ndryshme për lëshimit e ketyre recetave.

Shoqata e Farmacistëve Amerikanë gjithashtu nxiti [urged](#) kompanite e sigurimeve shëndetësore dhe menaxherët e kompanive farmaceutike për të hequr / zbutur menjëherë pengesat administrative.

Përgjegjësitë dhe roli i farmacive spitalore

Farmacitë spitalore në zonat e prekura dhe jo të prekura luajnë një rol të rëndësishëm në:

- Sigurimin e ruajtjes dhe furnizimit me stok të përshtatshëm të barnave të nevojshme e produkteve dhe pajisjeve të tjera mjekësore për të përmbushur kërkesën, përfshirë maska, termometra, syze dhe pajisje të tjera të nevojshme. Sigurimi furnizimit të këtyre produkteve siç duhet nëse nuk menaxhohen nga farmacia spitalore.
- Bashkëpunim me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor në ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes së pacientëve
- Promovimi spitalor për parandalimin dhe kontrollin e infeksionit
- Informimi dhe këshillimi
- Sigurimi i përdorimit të përgjegjshëm të produkteve farmaceutike të furnizuara. Për shembull, sigurimi që profesionistët e kujdesit shëndetësor i veshin maskat e tyre në mënyrën e duhur dhe të dinë se si t'i heqin ato siç duhet për të shmangur ndotjen.

- Farmakovigilanca dhe rezultatet e trajtimit të monitorimit.

Gjatë pandemisë, përveç farmacive të rrjetit të hapur dhe roleve të lidhura me COVID-19, farmacitë spitalore ofrojnë një shërbim thelbësor për pacientët (si pacientë jashtë, ashtu edhe brënda në spital) dhe ekipe të kujdesit shëndetësor përmes furnizimit me barna dhe kujdes farmaceutik. Sigurimi i vazhdimësisë së këtyre shërbimeve është thelbësor.

Aktivitetet e farmacisë

Stafi i farmacisë

Megjithëse është e rëndësishme që i gjithë stafi i farmacisë të jetë i njohur me këto udhëzime dhe këshilla, vlerësimi i rrezikut të pacientit nga COVID-19 në mesin e popullatës duhet të udhëhiqet nga farmacistët e rrjetit të hapur. Ata janë gjithashtu përgjegjës për referimin e duhur të rasteve të dyshuara në institucionet përkatëse të kujdesit shëndetësor dhe në autoritetet përkatëse.

Natyrisht, ekziston mundësia e ekspozimit të farmacistëve të linjës së parë ndaj COVID-19, sepse ato po bashkëveprojnë me pacientë që ndoshta janë të infektuar, prandaj punonjësit e kujdesit shëndetësor duhet të marrin masa për të mbrojtur veten gjithashtu.

I gjithë ekipi i farmacive duhet të jetë i trajnuar jo vetëm të dijë se çfarë të bëjë kur ekziston dyshimi për infeksion nga COVID-19, por edhe për të promovuar masa për të parandaluar infeksionin në publik. Prandaj, rekomandohet që i gjithë ekipi i farmacive të trajnohet në:

- Informacion teknik dhe shkencor për COVID-19, veçanërisht për simptomat, periudhën e inkubacionit dhe mënyrat e transmetimit të virusit;
- Informacion epidemiologjik për zonat e prekura. Për shifrat e përditësuara të numrit të rasteve të konfirmuara për çdo vend, vizitoni faqen në internet <https://www.worldometers.info/coronavirus/> dhe / ose faqja në internet e zhvilluar nga Qendra për Shkencë dhe Inxhinieri e Sistemeve në Universitetin Johns Hopkins.
- Informacion mbi masat parandaluese përfshirë informacionin për dezinfektuesit dhe higjenën e duhur të duarve - dhe nëse është e nevojshme, fytyrën;
- Informacione se si të procedohet për një rast të dyshuar, përfshirë strategjitë që duhet të zbatohet secila farmaci;
- Materialet në dispozicion për të mbështetur ndërhyrjen (fletushkat e informacionit, tabelat e përhapjes së virusit, dhe faqet e internetit të sakta të informacionit). (Centro de Informação do Medicamento - CEDIME Portugal, 2020)

Veprimet dhe pajisjet e farmacisë: garantimi i sigurisë dhe vazhdimësinë e shërbimit

Mbikëqyrja profesionale / administratori i farmacisë

Në rast se administratori i farmacisë nuk mund të sigurojë praninë dhe rolin e tij / saj në farmaci, këto mund të merren nga një farmacist i dytë i cili mund ose nuk i përket personelit të farmacisë. Ky farmacist “i dytë” duhet të marrë përgjegjësinë për mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive të farmacisë dhe të gjithë personelit.

Oraret e hapjes

Në rast se një farmaci nuk mund të sigurojë hapjen e aktivitetit në orët e saj normale të hapjes në mungesës së stafit për shkak të COVID-19, oraret e reja të hapjes duhet t'i komunikohen publikut në një vend të dukshëm të paktën jashtë farmacisë. Oraret e reja të hapjes duhet të sigurojnë shërbime minimale për komunitetin në drejtim të furnizimit me barna.

Shërbimi i pacientit / klientit

Për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit të barnave dhe shërbimeve për zonat ku ka vetëm një farmaci në një rreze të caktuar (e cila mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin), kontakti me pacientët / klientët duhet të minimizohet duke shpërndarë barna përmes një dritareje të vogël në fasadë ose derë, si ato që përdoren shpesh për shërbime të natës.

Një mburojë plastike gjithashtu mund të vihet përpara zonës së shpërndarjes, ose shenja të vendosura në tokë për të treguar distancën 1-2 m ndërmjet klientëve dhe stafit. Në rast se asnjëra prej këtyre masave nuk është e mundur, pacientët / klientët nuk duhet të hyjnë në farmaci dhe farmacistët këshillohen të përdorin pajisje të përshtatshme mbrojtëse individuale, përfshirë maska dhe syze, kur është e nevojshme.

Farmacitë në përgjithësi këshillohen gjithashtu të shpërndajnë barna përmes kësaj dritareje sa herë që kjo është e nevojshme për të minimizuar kontaktin dhe kështu duke siguruar vazhdimësinë e shërbimit.

Për të shmangur mbipopullimin e njerëzve brenda farmacisë, pacientët dhe klientët duhet t'u kërkohet që të presin radhën e tyre jashtë farmacisë. Në çdo rast, pacientët / klientët duhet të mbajnë një distancë prej 1-2 metrash midis tyre duke pritur në radhë.

Furnizimi me barna

Gjatë pandemisë, farmacistët duhet të japin përparësi në shpërndarjen e barnave dhe pajisjeve mjekësore kryesore dhe jo atyre të parëndësishme për momentin.

Kur është e përshtatshme, furnizimi i barnave në farmaci duhet të bëhet vetëm në prani të stafit të farmacisë, pa praninë e personave jashtë këtij stafi (ose të paktën zonat specifike të farmacisë ku nuk ka prani njerëzish të tjerë). Për më tepër, paketimet e përdorura nga importues shpërndarësit për të furnizuar farmacinë duhet të pastrohen dhe dezinfektohen para se të futen brenda ambienteve të farmacisë.

Dorëzimi i barnave në shtëpi

Për të siguruar furnizimin e duhur të barnave për pacientët, dhe veçanërisht në qytetet e vogla ku mund të jenë mbyllur farmacistët përkatëse, farmacistët e hapura mund të organizojnë shpërndarjen në shtëpi të barnave. Farmacistët që janë në gjendje të ofrojnë këtë shërbim inkurajohen ta bëjnë këtë, veçanërisht për pacientët që mund të jenë në karantinë ose izolim në shtëpi, apo ata të cilët mund t'i përkasin një grupi më të lartë rreziku ose që nuk mund të levizin.

Në rastin e dërgesave në shtëpi, personi përgjegjës për dërgesën duhet të shmangë çdo kontakt të drejtpërdrejtë me pacientin dhe objektet e tyre personale. Barnat dhe sendet e tjera mund të lihen jashtë derës së pacientit / klientit ose në një vend tjetër të caktuar, dhe dorëzuesi duhet të lëvizë për të mbajtur një distancë të sigurt prej 1-2 metrash duke siguruar vizualisht që barnat merren nga pacienti ose një person i autorizuar .

Federata Italiane e Pronarëve të Farmacive të Rrjetit të Hapur (FEDERFARMA) vendosi një partneritet me Kryqin e Kuq Italian për një shërbim të ofrimit falas 24 orë në ditë për pacientët më të vjetër se 65 vjeç që ndodhen në karantinë ose në shtëpi. (Federfarma, 2020)

Kur është e përshtatshme dhe e mundur, farmacistët e rrjetit të hapur mund të bashkëpunojnë me spitalet në dhënien e barnave të nevojshme. (INFARMED - Autoridade Nacional do Medicamento e Produtos de Saúde, 2020)

Zonë publike

1. Aksesi në produkte që vetë-përzgjidhen nga klientët duhet të kufizohet, për të shmangur që shumë njerëz të kenë kontakte me këto produkte. Ata duhet të aksesohen vetëm nga personeli i farmacisë.

Njoftim për pacientët/klientët

Vendosni një njoftim në hyrje të farmacisë me rekomandimet kryesore që pacientët / klientët duhet të marrin parasysh përpara se të hyjnë, siç janë:

1. Dezinfektoni duart kur hyni në farmaci;
2. Sigurohuni që të mbani një distancë prej 1-2 metrash midis jush dhe klientëve të tjerë dhe kujtdo që është në stafin e farmacisë;
3. Mos ecni jashtë shenjave të dyshemesë, nëse ka;
4. Nëse teshtini ose kolliteni, mbulonni hundën dhe gojën me shami (të cilën duhet ta hidhni në një enë të përshtatshme dhe të mos e përdorni përsëri) ose me një bërnyll të përkulur;
5. Shmangni shtrëngimin e duarve dhe kontaktet fizike gjatë kohës në farmaci;
6. Përgatisni paraprakisht recetat që duhet të plotësoni.

Në banak

1. Kur është e mundur, caktoni një punonjës për sportel ose përgjatë hapsirës në banak dhe shmangni shkëmbimet me pacientët/klientët.
2. I gjithë personeli i farmacisë në banak është i inkurajuar që të veshin një maskë për mbrojtje shtesë të vetes dhe popullatës.
3. Mbani në banak vetëm objektet thelbësore.
4. Fshini dhe dezinfektoni banakun pas secilit klient / pacient.
5. Mbani një dezinfektant me bazë alkooli pranë, për të dezinfektuar duart pasi të ndërveproni me secilin pacient / klient.
6. Kur është e mundur, inkurajoni pacientët që të porosisin barnat e tyre përmes faqes në internet të farmacisë (në varësi të juridiksionit) dhe të dorëzohen në shtëpinë e tyre ose vendin e punës.

Distancimi social

1. Kufizoni numrin e pacientëve / klientëve që hyjnë në farmaci në çdo kohë.
2. Vendosni një distancë të sigurt prej të paktën 1 metër (preferohet më shumë) kur ndërveproni me një pacient.
3. Nëse është e nevojshme, një tabaka mund të përdoret për të mbledhur recetat, dorëzuar barnat dhe për pagesën në mënyrë që të tejkaloni këtë distancë.
4. Këshilloni pacientët të të mbajnë një distancë të sigurt prej të paktën 1 metër midis tyre ndërsa presin, dhe të përdorni pika shënuese në dysheme për të treguar se ku mund të qëndrojnë;

Këshilloni pacientët/klientët të:

1. Shmangin qëndrimet e gjata në farmaci.
2. Të shmangin vizitën në farmaci pacientët që janë të moshuar ose kanë komorbiditete. Kurdo që të jetë e mundur, pacientë të tillë duhet të kërkojnë nga një anëtar i familjes, një mik apo një fqinj që të shkojë në farmaci në vend të tyre. (Associação Nacional das Farmácias de Portugal, 2020)

Rekomandime për shërbime farmaceutike dhe aktivitete në farmaci

1. Shërbimet shëndetësore (matja e presionit të gjakut, kolesterolit, glicemisë), testet e shtatëzënësive, ose administrimi i vaksinave dhe injeksioneve (kudo që është i autorizuar), dhe çdo shërbim tjetër që kërkon kontakt të drejtpërdrejtë me një pacient duhet të ndjekë masa shtesë mbrojtëse, siç është përdorimi i një maske dhe dorezave.
2. Shërbimet e përmendura në pikën e mëparshme mund të kenë nevojë të kufizohen ose ndërpriten nëse ato mund të paraqesin një rrezik për shëndetin e stafit (p.sh., për pacientët me simptoma të COVID-19).

Rekomandime për ekipin e farmacistëve

1. Për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve në farmaci, rekomandohet që ta ndani ekipin në ndërrime turnesh sa herë që të jetë e mundur (për shembull, një në mëngjes dhe një pasdite), me mbylljen e mundshme të farmacisë midis këtyre turneve, për të dezinfektuar të gjithë farmacinë, duke siguruar që anëtarët e secilit

turn nuk kanë përplasje.

2. Punonjësit me sëmundje që komprometojnë sistemin e tyre imunitar duhet të përdorin maska dhe mundësisht të kryejnë detyra në pjesën e prapme të farmacisë. Masat e higjienës së duarve duhet të përforcohen.
3. Punonjësit duhet të ndryshojnë rrobat më shpesh.
4. Duhet të shmangët veshja e aksesorëve si rrathë, orë dhe unaza.
5. Flokët e gjata ose mjekra mund të zvogëlojnë efikasitetin e maskave.
6. Kurdo që është e nevojshme të vishni maskë dhe / ose syze, higjena dhe dezinfektimi i duarve duhet të kryhet para dhe pas.

Masa parandaluese

Farmacistët dhe stafi i farmacisë mund të luajnë një rol kryesor në parandalimin e përhapjes së koronavirusit SARS-CoV-2 nga:

- Të kuptuarit e natyrës së sëmundjes, si transmetohet dhe si ta parandaloni atë të përhapet më tej;
- Të dini të aksesoni në burimet e informacionit në nivel kombëtar në lidhje me strategjitë COVID-19 (përfshirë qendrën më të afërt të referimit për COVID-19), dhe duke e përditësuar atë informacion;
- Informimi, këshillimi dhe edukimi i popullatës;
- Furnizimi i produkteve të përshtatshme;
- Inkurajimi i individëve dhe familjeve (të dyshuar me COVID-19) që të vetë-izolohen në shtëpi nëse simptomat janë të lehta dhe pacientët e prekur nuk bëjnë pjesë në grupet me rrezik më të lartë. (mbi 65 vjeç, me sëmundje kardiovaskulare ose të frymëmarrjes., diabet, kancer, kushte të tjera kongjenitale ose sëmundje të tjera që mund të rrezikojnë përgjigjen imunitare). Pacientët që i përkasin grupeve të tilla duhet të referohen në institucionet e duhura të kujdesit shëndetësor për një test ekzaminimi dhe ndjekje të përshtatshme.

Qendrat e kujdesit parësor, farmacitë ose institucionet e tjera të kujdesit shëndetësor (përfshirë ato të mjekësisë tradicionale) që nuk kanë pajisje dhe një mjedis të tillë mund të luajnë një rol kryesor në parandalimin e sëmundjes, por ato nuk kanë kushtet e duhura për të trajtuar ose menaxhuar pacientë me COVID-19.

Përpjekja për të trajtuar pacientët në mjedise të papërshtatshme mund të rrezikojë profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe të tjerët, ndërkohë që ata duhet të kërkojnë të lehtësojnë këtë gjë.

Për më tepër, masat e mëposhtme duhet të merren parasysh nga administratori/ët i/ e farmacisë

(Chinese Pharmaceutical Association, 2020):

1. Zhvilloni plane emergjente në rastet me fluks pune
2. Kryeni trajnime të plota për personelin
3. Përqendrohuni në gjendjen shëndetësore të farmacistëve
4. Mbronni personelin e farmacisë
5. Forconi monitorimin e infeksionit nga farmacistët
6. Siguroni një menaxhim të përshtatshëm të pastrimit dhe dezinfektimit
7. Forconi menaxhimin e pacientit
8. Forconi informimin e pacientëve
9. Forconi menaxhimin e ekspozimit ndaj infeksionit
10. Forcimi i menaxhimit të mbetjeve mjekësore

Udhëzimi i detajuar për secilën pikë jepet nga Shoqata Kineze Farmaceutike në dokumentin i cili mund të gjendet në [FIP dedicated webpage](#).

Përdorimi i maskave: Rekomandime për stafin e farmacisë dhe popullatën

Studimet e fundit kanë treguar që grimcat e ajrit të infektuara mund të qarkullojnë në ajër deri në tre orë (Neeltje van Doremalen, 2020). Procedurat e gjenerimit të grimcave të infektuara ka më shumë të ngjarë të ndodhin në një mjedis të kujdesit mjekësor dhe përfshijnë intubimin trakeal, ventilimin jo-invaziv, trakeotominë, ringjalljen kardiopulmonare, ventilimin manual para intubimit dhe bronkoskopisë. (World Health Organization, 2020). Gjatë teshtimës ose kollitjes, spërklat e mëdha përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të përgjithshëm të pikave të frymëmarrjes të nxjerra, dhe këto kanë tendencë të bien shpejt në tokë. Sidoqoftë, teshtima dhe kollitja gjithashtu mund të prodhojnë aerosole mjaft të vogla që qëndrojnë në ajër për ca kohë dhe për tu thithur nga të tjerët. Gjithsesi, kjo do të ndikohet nga një sërë faktorësh si graviteti, drejtimi dhe forca e ajrit, temperatura dhe lagështia relative (të cilat do të ndikojnë si në madhësinë dhe masën e spërklave për shkak të avullimit) (World Health Organization, 2009).

Rekomandime për farmacistët dhe për stafin e farmacisë

Sipas Administratës së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, stafi i farmacisë mund të konsiderohet se është në rrezik të ekspozimit të mesëm për COVID-19, pasi ata kanë kontakte të shpeshta dhe / ose fizike me njerëz që mund të jenë të infektuar me SARS-CoV-2, por të cilët nuk janë evidentuar si pacientë me COVID-19. Në zonat ku udhëtarë të ndryshëm kthehen nga udhëtimet e mëparshme në zona ku ka pasur raste të infektuarish me COVID-19 ka një rrezikshmëri më të lartë që punonjësit e këtyre pikave të preken nga virusi. Punonjësit e këtyre pikave mund të kenë kontakte me publikun e gjerë (p.sh., në shkollë, ambiente pune me densitet të lartë, etj). (US Department of Labor - Occupational Safety and Health Administration, 2020)

Duke marrë parasysh që transmetimi ka ndodhur nga individë asimptomatikë dhe / ose para-simptomatikë (Ruiyun Li, 2020) dhe kontaktin e shpeshtë që farmacistët dhe stafi i farmacisë kanë me publikun (përfshirë personat e infektuar), **është e arsyeshme të rekomandohet që personeli i farmacisë të veshë një maskë për të mbrojtur veten nga infeksioni, dhe për të shmangur përhapjen e mëtejshme në rast se personeli i farmacisë infektohet vetë.**

Duke qenë individë me rrezik ekspozimi të mesëm, ata mund të kenë nevojë të veshin një kombinim dorezash, një veshje mbi rroba, një maskë për fytyrën dhe / ose një mburojë të fytyrës ose syze. Sidoqoftë, veshja e maskës, përdorimi i dorezave dhe mbrojtja e syve për punëtorët në kategorinë e rrezikut të ekspozimit të mesëm do të ndryshojnë sipas detyrës së punës, rezultateve të vlerësimit të rrezikut të punëdhënësit dhe llojeve të ekspozimeve që punëtorët kanë të bëjnë në punë.

. (US Department of Labor - Occupational Safety and Health Administration, 2020)

Në çdo rast, është parësore që farmacistët dhe stafi i farmacisë të mbrojnë më tej veten nga infeksioni duke mbajtur një distancë të sigurt 1-2 metra nga pacientët, duke përdorur pajisjet e duhura mbrojtëse personale dhe dezinfektojnë çdo sipërfaqe që mund të preket nga pacientët.

Veshja e një maskë mjekësore është një nga masat parandaluese për të kufizuar përhapjen e disa sëmundjeve të frymëmarrjes, përfshirë COVID-19. Sidoqoftë, **përdorimi i vetëm një maskë është i pamjaftueshëm për të siguruar një mbrojtje të duhur** dhe duhet të merren masa të tjera po aq të rëndësishme.

Nëse vishni siç duhet, një maskë ndihmon në bllokimin e sekrecioneve të frymëmarrjes të prodhuara nga mbajtësi i maskës për mos ndotur personat e tjerë dhe sipërfaqet e ndryshme (shpesh quhet kontrolli i burimit). (Centers for Disease Control and Prevention, 2020). Nëse do të përdoren maska, kjo masë duhet të kombinohet me higjienën e duarve dhe masat e tjera të kontrollit të infeksionit dhe parandalimit për të shmangur transmetimin nga COVID-19 nga njeriu tek njeriu.

OBSH rekomandon që punonjësit e kujdesit shëndetësor duhet:

- Vishni një maskë mjekësore kur hyni në një dhomë ku ka pacientët të dyshuar ose të konfirmuar që janë të infektuar me COVID-19;
- Përdorni një respirator të paktën po aq mbrojtës sa rekomandon Instituti Kombëtar i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (NIOSH) N95, standardi i Bashkimit Evropian (EU) FFP2, ose ekuivalent, kur kryeni procedura të gjenerimit të aerosolit, të tilla si intubimi trakeal, ventilimi jo-invaziv, trakeotomia, ringjallja kardiopulmonare, ventilimi manual para intubacionit dhe bronkoskopia. (World Health Organization, 2020)

Për farmacistët që punojnë në spitale dhe institucione të kujdesit shëndetësor

Në rolin e tyre këshillues për përdorimin e duhur dhe të përgjegjshëm të produkteve farmaceutike për stafin e reparteve spitalore, farmacistët spitalorë duhet të jenë të vetëdijshëm për rekomandimet në lidhje me maskat.

Qendrat e SHBA për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) ka lëshuar udhëzime për tre faktorët kryesorë që një respirator të jetë efektiv:

1. Respiratori duhet të vendoset në menyren e duhur dhe duhet të mbahet veshur gjatë ekspozimit.
2. Respiratori duhet të përshtatet mirë me fytyrën e përdoruesit për të siguruar që të mos ketë boshllëqe midis lëkurës së përdoruesit dhe valvulës së respiratorit.
3. Filtri i respiratorit duhet të kapë më shumë se 95% të grimcave të ajrit që kalon nëpër të. (Centers for Disease Control and Prevention, 2020)

Për udhëzime për përdorimin e saktë (dhe të pasaktë) të respiratorëve, shihni [CDC brochure](#).

Përdorimi i një respiratori

- Përdorni një respirator që është të paktën po aq mbrojtës sa NIOSH N95 përpara hyrjes në dhomën e pacientit ose në zonën e kujdesit.
- Respiratorët duhet të hiqen dhe të hidhen pasi të dalin nga dhoma apo zona e kujdesit të pacientit dhe pasi të mbyllim derën. Kryeni higjienën e duarve pasi hidhni respiratorët.
- Nëse përdoren respirator që mund të ripërdoren (p.sh., respirator pastrues të ajrit me energji elektrike / PAPR), ato duhet të pastrohen dhe dezinfektohen sipas udhëzimeve të prodhuesit para ripërdorimit.
- Përdorimi i respiratorit duhet të jetë në kontekstin e një programi të plotë të mbrojtjes respiratore, në përputhje me standardet e Mbrojtjes së Administrimit dhe Sigurisë së Shëndetit (OSHA).
Stafi duhet të mos ketë komorbiditete dhe duhet të jetë në gjëndje të përballojë maskën e posaçme (p.sh. një N95 të çertifikuar NIOSH) dhe të trajnohen në përdorimin e duhur të respiratorëve, heqjen dhe largimin e sigurt dhe kundërindikimet mjekësore ndaj përdorimit të respiratorit.

Përveç kësaj, dhe veçanërisht gjatë periudhave pandemike, rekomandimet e zakonshme të higjienës duhet të konsiderohen nga farmacistët dhe stafi i farmacisë: flokë të shkurtër ose flokë të lidhur, shmangia e mjekrave të gjata, dhe shmangia e përdorimit të argjendarisë, orëve dhe makizhit, të gjitha kontribuojnë në parandalimin më të mirë të infeksionit dhe një përdorim më efikas të maskave, respiratorëve dhe syzeve.

Rekomandime për publikun

Në lidhje me përdorimin e maskave nga publiku, pasi dëshmitë sugjerojnë që COVID-19 mund të transmetohet përpara shfaqjes së simptomave, transmetimi midis personave në

komunitet mund të zvogëlohet nëse të gjithë, përfshirë njerëzit që janë infektuar, por edhe ata që janë asimptomatikë, të veshin maska për fytyrën. Sidoqoftë, provat që maskat në fytyrë mund të sigurojnë mbrojtje efektive kundër infeksioneve të frymëmarrjes në komunitet janë të pakta. Për më tepër, përdorimi i maskave për fytyrën nga popullata përkeqëson mungesën globale të furnizimit me maska për fytyrën, me rritjen e çmimeve dhe rrezikon kufizimet e furnizimit për profesionistët e kujdesit shëndetësor. (Shuo Feng, 2020)

Ndërkohë, autoritetet shëndetësore duhet të optimizojnë shpërndarjen e maskave për të dhënë përparësi në nevojat e punonjësve të kujdesit shëndetësor të vijës së parë dhe të popullsisë më të prekshme në komunitete që janë më të ndjeshëm ndaj infeksionit dhe vdekshmërisë nëse infektohen, përfshirë edhe të moshuarit (veçanërisht ata më të vjetër se 65 vjeç) dhe njerëzit me komorbiditete shëndetësore. Veçanërisht, përdorimi jo i duhur i maskave të fytyrës, të tilla si mos ndryshimi i maskave një përdorimëshe, mund të rrezikojë efektin mbrojtës dhe madje të rrisë rrezikun e infeksionit. (Shuo Feng, 2020)

Do të ishte gjithashtu racionale të rekomandoni që njerëzit në karantinë të veshin maska nëse duhet të largohen nga shtëpia për ndonjë arsye, për të parandaluar transmetimin e mundshëm asimptomatik ose presimptomatik. Për më tepër, popullatat e prekshme, siç janë të moshuarit më të vjetër dhe ata me komorbiditete, duhet të veshin maska për fytyrën nëse është e mundur. (Shuo Feng, 2020)

Si përmbledhje, FIP rekomandon që popullata të mbajë një maskë në rrethanat e mëposhtme:

- Kur kujdeseni për një person të infektuar me COVID-19.
- Kur paraqitni simptoma të tilla si kollitja, teshtima ose ethe.
- Nëse ato i përkasin grupeve me rrezik më të lartë, përfshirë të moshuarit më të vjetër (veçanërisht ata më të vjetër se 65 vjeç) dhe njerëzit me komorbiditete kur janë në vende publike ose në prani të të tjerëve.
- Kur janë në karantinë (d.m.th., në izolim parandalues pas kontaktit me një rast të konfirmuar ose potencialisht pozitiv të COVID-19), nëse ata kanë nevojë të largohen nga shtëpia për ndonjë arsye, për të parandaluar një transmetim të mundshëm asimptomatik ose para-simptomatik.

Duhet të theksohet se:

Maska është efektive vetëm kur përdoret në kombinim me pastrimin e shpeshtë të duarve me dezinfektues me bazë alkooli ose sapun dhe ujë.

- Nëse njerëzit veshin një maskë, atëherë ata duhet të dinë ta përdorin atë dhe ta heqin si duhet. (World Health Organization, 2020)

Si të vishni, përdorni, të hiqni dhe hidhni një maskë

1. Para se të prekni maskën, dezinfektoni duart me një dezinfektues me bazë alkooli ose sapun dhe ujë
2. Para se të vendosni maskën, inspektojeni atë për të çara dhe vrima.
3. Orientoni se cila anë është ana e sipërme (përgjithësisht aty ku është shirita metalikë ose skaji i ngurtë).
4. Sigurohuni për anën e duhur të maskës (zakonisht ana me ngjyrë) që përballet me pjesën e jashtme.
5. Vendoseni maskën në fytyrën tuaj. Vendosni shiritin metalik ose skajin e ngurtë të maskës në mënyrë që të marrë formën e hundës tuaj.
6. Sigurohuni që maska të mbulojë gojën dhe mjekrën.
7. Pas përdorimit, hiqni maskën; hiqni lidhëset elastike nga prapa veshëve duke e mbajtur maskën larg fytyrës dhe rrobave. Shmangni prekjen e sipërfaqeve potencialisht të kontaminuara të maskës.
8. Hidhni maskën në një kosh të mbyllur menjëherë pas përdorimit.

9. Kryeni proçesin e higjenizimit të duarve pas prekjes ose heqjes së maskës. Përdorni dezinfektant me bazë alkooli ose nëse janë të ndotura dukshëm, lani duart tuaja me sapun dhe ujë. (World Health Organization, 2020). Gjithashtu lani dhe fytyrën nëqoftëse është e mundur.

Maskat mjekësore mund të përdoren për të parandaluar përhapjen e infeksioneve të frymëmarrjes

Ekzistojnë 2 lloje kryesore të maskave mjekësore: **maska për fytyrën** dhe **respiratorët N95**.



Maskat për fytyrën janë më të lirshme dhe parandalojnë përhapjen e spërklave nëse kolliteni ose teshtitni.

Respiratorët N95 janë më të shtrënguar dhe parandalojnë thithjen e grimcave infektive më të vogla që vijnë nga ajri.

Respiratorët N95 nuk rekomandohen për përdorim nga publiku i gjerë.

Maska për fytyrën duhet të përdoren vetëm nga:

- ✓ Individët me simptoma të infeksionit respirator si kolla, teshtimat, dhe ndonjëherë ethe.
- ✓ Punonjësit e kujdesit shëndetësor
- ✓ Personat që kujdesen ose në kontakt të ngushtë me dikë me infeksion të frymëmarrjes

Si duhet ta përdor maskën e fytyrës?

- 1 Lani duart për të paktën 20 sekonda para se të vendosni maskën.
- 2 Vendoseni maskën mbi hundë dhe gojë. Sigurohuni të mos lini boshllëqe dhe lidhni mire llastikët ose shiritat.



- 3 Shmangni prekjën e maskës. Nëse e bëni këtë, lani duart për të paktën 20 sekonda.
- 4 Hiqni maskën pa prekur pjesën e përparme. Hidheni në një kosh të mbyllur.
- 5 Lani duart përsëri për të paktën 20 sekonda.



Imazhi: Angel N. Desai, and Preeti Mehrotra. JAMA, 2020-03-04. doi:10.1001/jama.2020.2331

Tre faktorë kryesore që një respirator të jetë efektiv:



① Respiratori duhet të vendoset në mënyrë korrekte dhe të mbahet gjatë ekspozimit

② Respiratori duhet të përputhet mirë në fytyrë duke mos lënë boshllëqe midis lëkurës dhe valvulës së respiratorit

③ Filtri i respiratorit duhet të mbajë 95% të grimcave të ajrit që e përshkojnë atë.

CDC **NIOSH**

*Nëse respiratori ka një shufër metalike apo një jastëk të modeluar për hundën, ajo duhet të vendoset mbi hundë dhe jo në faqe.

Imazhi: Ronald Shaffer, PhD; Jaclyn Krahn Cichowicz, MA; Ginger Chew, ScD; and LCDR Joy Hsu, MD, MS. CDCs, 2018. <https://blogs.cdc.gov/niosh-science-blog/2018/01/04/respirators-public-use/>

Këshilla për popullatën

Individët pa simptoma duhet:

1. Shmangni tubimet e mëdha dhe hapësirat e mbyllura të mbushura me njerëz;
2. Mbani një distancë prej të paktën 1-2 metra nga çdo individ me simptoma të COVID-19 (p.sh., kollitja, teshtima) dhe çdo individ në përgjithësi kur ka transmetim të sëmundjes në popullatën tuaj;
3. Higjenzoni duart shpesh, duke përdorur dezinfektant me bazë alkooli nëse duart nuk janë të ndotura dukshëm ose sapun dhe ujë kur duart janë të ndotura dukshëm;
4. Nëse kolliteni ose tështini mbuloni hundën dhe gojën tuaj me një bërryl të përthyer ose facoletë, hidhni facoletën menjëherë pas përdorimit dhe kryeni procesin e higjenzimit të duarve;
5. Shmangni prekjen e gojës, hundës dhe syve para se të lani duart;
6. Shmangni vizitat e të moshuarve, pasi ata janë veçanërisht të prekshëm ndaj COVID-19.

[Udhëzime shtesë mund të gjenden në Rekomandimet e Përkohshme të Kontrollit të Brendshëm të CDC dhe Kontrollit për Pacientët e dyshur ose konfirmuar me sëmundjen e koronavirusit 2019 \(COVID-19\) në Cilësimet e Kujdesit Shëndetësor. \(Centers for Disease Control and Prevention, 2020\)](#)

Rekomandime për pacientët e jashtëm

Parimet themelore të parandalimit dhe kontrollit të infeksionit dhe masat paraprake standarde duhet të zbatohen në të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor, përfshirë kujdesin ambulator dhe kujdesin parësor. Për COVID-19, masat e mëposhtme duhet të miratohen:

- Evidentimi dhe njohja e hershme:

- Theksimi i higjenizimit të duarve, higjenës së frymëmarrjes dhe maskave mjekësore që duhen përdorur nga pacientët me simptoma;
- Përdorimi i duhur i masave paraprake mbrojtëse për kontaktet midis njerëzve dhe spërklave;
- Prioriteti shërbimi për pacientët simptomatikë;
- Kur pacientëve simptomatikë u kërkohet të presin, sigurohuni që ata kanë një zonë të veçantë pritjeje;
- Edukoni pacientët dhe familjet për njohjen e hershme të simptomave, masat paraprake themelore që duhet të përdoren dhe cilat janë institucionet e kujdesit shëndetësor të cilave duhet t'i referohen. (World Health Organization, 2020)

Veprimet e farmacive të rrjetit të hapur dhe këshillimi i pacientit

Për shkak të aksesimit së tyre dhe shpërndarjes së gjerë gjeografike në shumicën e vendeve, farmacitë e rrjetit të hapur shpesh janë pika e parë e kontaktit të popullatës me sistemin e kujdesit shëndetësor - dhe kjo përfshin situata të shpërthimit të sëmundjeve dhe pandemive. Prandaj, farmacitë kanë një rol të rëndësishëm jo vetëm në sigurimin e aksesimit në medikamente dhe pajisje mjekësore, por edhe në shëndetin publik, kryesisht duke informuar publikun për masat parandaluese, këshillimin për masat paraprake të mbrojtjes dhe në vlerësimin e rrezikut, zbulimin e hershëm dhe referimin e individëve që dyshohet se janë në një rrezik më të lartë për t'u infektuar.

Është e rëndësishme që farmacistët të ofrojnë siguri për publikun në përgjithësi, në mënyrë që njerëzit të mbrojnë veten dhe të tjerët bazuar në prova të sakta shkencore dhe sjellje racionale, dhe të mos drejtohen nga paniku.

Në të gjitha rastet, është e rëndësishme që farmacistët dhe stafi i farmacisë të mbrojnë veten nga infeksioni duke mbajtur një distancë të sigurt nga pacientët dhe popullata në përgjithësi dhe duke dezinfektuar shpesh çdo sipërfaqe që mund të preket prej tyre.

Meqenëse infeksioni mund të përhapet nga individë asimptomatikë ose para-simptomatikë (Ruiyun Li, 2020), rekomandohet të merren masa paraprake me të gjithë klientët dhe pacientët që hyjnë në farmaci.

Bazuar në vlerësimin e simptomave të një individ dhe historisë së fundit të udhëtimeve dhe / ose kontaktit me raste të konfirmuara ose të dyshuara të COVID-19, farmacistët duhet të vlerësojnë rrezikun dhe të ndërhyjnë / këshillojnë në përputhje me rrethanat, si në tabelën më poshtë. (Centro de Informação do Medicamento - CEDIME Portugal, 2020).

Duhet të konsiderohet se në një numër të madh vendesh, përhapja në komunitet është bërë forma kryesore e transmetimit të sëmundjes. Prandaj duke patur parasysh këtë historia e udhëtimit në një nga zonat e prekura është ende një kriter i rëndësishëm në vendet me pak raste ose në një fazë fillestare të përhapjes, por ajo nuk do të jetë më një kriter kyç për evidentimin e transmetimit.

Kriteret	Ndërhyrja
<ul style="list-style-type: none"> • Pa simptoma (kollë, ethe ose problem me frymëmarrjen) DHE • Asnjë kontakt i kohëve të fundit me raste të konfirmuara ose të dyshuara me COVID-19 dhe asnjë histori aktuale udhëtimi në ndonjë nga vendet e prekura 	<ul style="list-style-type: none"> • Ofroni siguri • Theksoni masat parandaluese • Rekomandoni distancim social, izolimin në shtëpi, shmangien e udhëtimeve të cilat nuk janë të domosdoshme (lokale apo ndërkombëtare) kur është e mundur. • Siguroni informacione dhe këshilla të bazuara në prova (me goje dhe/ ose me shkrim)

<ul style="list-style-type: none"> • Me simptoma (kollë, ethe ose probleme me frymëmarrjen) DHE • Asnjë kontakt i kohëve të fundit me raste të konfirmuara ose të dyshuara me COVID-19 dhe asnjë histori aktuale udhëtimi ne ndonjë nga vendet e prekura. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ofroni siguri • Informoni që rreziku i COVID-19 mund të ekzistojë • Kur është e mundur, izoloni pacientin në një dhomë të veçantë. • Mos e vizitoni fizikisht pacientin • Forconi masat vetëmbrojtëse, përfshirë përdorimin e një respiratori të përshtatshëm, doreza dhe syze • Theksoni masat për të parandaluar transmetimin e mëtejshëm, përfshirë përdorimin e një maskë për fytyrën nga pacienti • Rekomandoni distancë të rreptë sociale (përfshirë familjen dhe marrëdhëniet e ngushta), karantinimin në shtëpi dhe shmangien e të gjithë udhëtimeve (lokale dhe ndërkombëtare) për të paktën 14 ditë • Për individët e grupeve me rrezik më të lartë, këshilloni që të kontaktojnë numrin e emergjencës ose institucionin përkatës të kujdesit shëndetësor për testimin dhe kujdesin vijues dhe trajtimin. • Siguroni informacione dhe këshilla të bazuara në prova (me goje dhe/ ose me shkrim)
<ul style="list-style-type: none"> • Pa simptoma (kollë, ethe ose probleme me frymëmarrjen) DHE • Dihet se ka kontakt të kohëve të fundit me raste të konfirmuara me infeksionin e COVID-19 dhe/ose histori aktuale udhëtimi në një zone të prekur 	<ul style="list-style-type: none"> • Ofroni siguri • Informoni që rreziku i COVID-19 mund të ekzistojë • Rekomandoni distancë të rreptë sociale (përfshirë familjen dhe marrëdhëniet e ngushta), karantinën në shtëpi dhe shmangien e të gjithë udhëtimeve (vendase dhe ndërkombëtare) për të paktën 14 ditë • Rekomandoni gjurmimin e historisë së kontakteve • Nëse simptomat shfaqen pas 14 ditësh pas kontaktit me një rast të konfirmuar, merrni numrin e urgjencës dhe ndiqni instruksionet e posacme. • Siguroni informacione dhe këshilla të bazuara në prova (me goje dhe/ ose me shkrim)
<ul style="list-style-type: none"> • Me simptoma (kollë, ethe ose probleme me frymëmarrjen) DHE • Dihet se ka kontakt të kohëve të fundit me raste të konfirmuara me infeksionin e COVID-19 dhe/ose histori aktuale udhëtimi në një zone të prekur 	<ul style="list-style-type: none"> • Ofroni siguri • Informoni që rreziku i COVID-19 mund të ekzistojë • Kur është e mundur, izoloni pacientin në një dhomë të veçantë. • Mos e vizitoni fizikisht pacientin • Forconi masat vetëmbrojtëse, përfshirë përdorimin e një respiratori të përshtatshëm, doreza dhe syze • Theksoni masat për të parandaluar transmetimin e mëtejshëm, përfshirë përdorimin e një maskë për fytyrën nga pacienti • Rekomandoni distancë të rreptë sociale

	<p>(përfshirë familjen dhe marrëdhëniet e ngushta), karantinën në shtëpi dhe shmangien e të gjithë udhëtimeve (vendase dhe ndërkombëtare) për të paktën 14 ditë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për individët e grupeve me rrezik më të lartë, këshilloni të kontaktoni numrin e emergjencës ose institucionin përkatës të kujdesit shëndetësor për testimin dhe kujdesin vijues dhe trajtimin. • Siguroni informacione dhe këshilla të bazuara në prova (me goje dhe/ ose me shkrim)
<ul style="list-style-type: none"> • Plane të pashmangshme udhëtimi ose kontakti me persona që dyshohet apo dihet që janë të infektuar me COVID-19 	<ul style="list-style-type: none"> • Ofroni siguri • Informoni për situatën dhe mënyrat e transmetimit • Theksoni masat parandaluese (veçanërisht larja e shpeshtë e duarve dhe shmangia e prekjes së fytyrës së dikujt) • Theksoni masat e vetëmbrojtjes, përfshirë përdorimin e një respiratori të përshtatshëm • Siguroni informacione dhe këshilla të bazuara në prova (me goje dhe/ ose me shkrim)

Individëve që ndjehen mirë, duhet të këshillohen që të qëndrojnë në shtëpi dhe të zbatojnë masat e përgjithshme parandaluese për shumicën e infeksioneve të frymëmarrjes (shiko seksionin e veçantë më poshtë).

Protokolli në tabelën e mësipërme është paraqitur gjithashtu në formatin e një fletë udhëzuese përmbledhëse që mund të shfaqet në farmaci për personelin e farmacistë (dhënë si një dokument i veçantë).

Izolimi dhe referimi i pacientit

Nëse dyshoni se dikush mund të ketë COVID-19, inkurajoni dhe mbështesni atë për të qëndruar në shtëpi në karantinë ose për të kërkuar një trajtim të menjëhershëm mjekësor në një institucion të përshtatshëm të kujdesit shëndetësor nëse simptomat janë ose bëhen të forta. OBSH nuk këshillon familjet ose popullatën që të kujdesen për individët me simptoma të SARS-CoV-2 në shtëpi, përveç në rrethanat e përshkruara në seksionin specifik më poshtë.

Në drejtim të referimit të rasteve të dyshuara, autoritetet tuaja shëndetësore kombëtare, rajonale ose lokale mund të kenë hartuar protokolle për këtë, dhe është e rëndësishme që të njiheni me këto procedura, t'i ndiqni ato dhe të bashkëpunoni për zbatimin e tyre. Kjo mund të përfshijë izolimin, kur është e mundur, të rastit të dyshuar në një dhomë të veçantë dhe një telefonatë në numrin e emergjencave, ose që pacienti të vetë-karantinohet në shtëpi, bashkë me kontaktet e tij më të ngushta.

Kjo dhomë izolimi në farmaci idealisht duhet të ketë një banjë private me pajisjet minimale dhe objektet e nevojshme për rehatinë e personit gjatë pritjes, në mënyrë që të shmanget ndotja e mundshme e sendeve të tilla dhe nevoja për të dekontaminuar më shumë sende sesa është e nevojshme. Ndërsa janë në izolim, pacientëve u kërkohet të mbajnë një maskë. Pasi rasti i dyshuar është larguar nga farmacia, dhoma në të cilën pacienti ishte izoluar dhe çdo zone potencialisht e kontaminuar (si tualeti) duhet të pastrohet dhe dezinfektohet duke përdorur produkte dhe procedura të përshtatshme (shiko seksionin specifik më poshtë).

Trajtimi në shtëpi për pacientët që kanë simptoma të lehta dhe dyshohet se kanë COVID-19

OBSH rekomandon që rastet e dyshuara me COVID-19 të izoloohen dhe monitorohen në një ambient spitalor për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor (në rast se simptomat e pacientëve përkeqësohen) dhe sigurinë e shëndetit publik. Sidoqoftë, për disa arsye të mundshme, përfshirë situatat kur kujdesi spitalor nuk është i disponueshëm ose i pasigurt (p.sh. kapaciteti i kufizuar dhe pamundësia për të përmbushur kërkesën për shërbim shëndetësor), ose në rast të refuzimit për shtrimin në spital, zgjidhjet alternative (përfshirë shtëpinë e pacientit) për sigurimin e kujdesit shëndetësor mund të duhet të merren në konsideratë.

Nëse ekziston një arsye e tillë, pacientët me simptoma të lehta dhe pa komorbiditete siç janë sëmundjet e mushkërive ose zemrës, insuficiencë renale, etj që i vendosin ata në rrezik më të madh të shfaqjes së komplikimeve mund të këshillohen nga stafi mjekësor që të kujdesen në shtëpi.

Për më tepër, pacientët dhe anëtarët e familjes duhet të edukohen për higjienën personale, masat kyçe të parandalimit të infeksionit, se si të kujdesen për anëtarin e familjes që dyshohet se është infektuar, dhe se si të parandalojnë përhapjen e infeksionit në familje. Ata duhet të përmbahen në një seri rekomandimesh që mund të gjenden më specifikisht në [guideline](#) nga OBSH.

Testi diagnostikues për njerëzit e dyshuar me COVID-19

Më 16 Mars 2020, Drejtori i Përgjithshëm i OBSH-së, Dr Tedros Adhanom Ghebreyesus, deklaroi se "mënyra më efektive për të parandaluar infeksionet dhe për të shpëtuar jetën është thyerja e zinxhirëve të transmetimit. Dhe për ta bërë atë, ju duhet të bëni testet dhe të izolojeni. Ju nuk mund të luftoni me një zjarr të hapur. Dhe ne nuk mund ta ndalojmë këtë pandemi, nëse nuk e dimë se kush është i infektuar. Ne kemi një mesazh të thjeshtë për të gjitha vendet: testoni, testoni, testoni." (Ghebreyesus, 2020)

Aktualisht ekzistojnë disa teste në dispozicion në treg (ose ka dhe të tjera që janë në zhvillim e sipër) për diagnostikimin e COVID-19 (infeksioni SARS-COV-2), të prodhuara në SH.B.A. apo në disa vende evropiane, në Kinë, Kore dhe vende të tjera. Ato kryesisht bazohen në diagnozën molekulare (reaksione komplekse të zinxhirit të polimerazës (PCR) ose teknikat e reagimit të zinxhirit të polimerazës së transkriptimit të kundërt (RT-PCR)) që synojnë pjesë të ndryshme të gjenomit viral.

Disa vlerësime serologjike janë gjithashtu në zhvillim, por aktualisht ato nuk mund të konkurrojnë në saktësi me diagnozën molekulare, veçanërisht në fazën e hershme të infeksionit. Kjo është veçanërisht e vërtetë për pacientët që janë të imunokompromentuar dhe tek të moshuarit. Kjo mungesë e ekuivalencës është gjithashtu e vërtetë për sa i përket performancës analitike.

Nëse kërkohet të krijoni një metodë diagnostikuese, personeli klinik i laboratorit duhet të pyesë në lidhje me rekomandimet dhe kërkesat e zbatueshme nga autoritetet e tyre shëndetësore kombëtare. Lidhja e mëposhtme ka një listë gjithëpërfshirëse të opsioneve diagnostikuese në dispozicion për SARS-CoV-2 <https://www.finddx.org/covid-19/pipeline/>

Testet nuk janë të gjitha ekuivalente në aspektin e ndjeshmërisë për shkak të sekuencës gjenomike virale ose gjen (-eve) të synuara virale. Aktualisht nuk ka të dhëna të besueshme shkencore në dispozicion për krijimin e një klasifikimi të ndjeshmërisë së testeve të ndryshme diagnostikuese në treg.

Pajisjet e para të testimit "të shpejtë" (qendrat e kujdesit) po hyjnë në treg në fund të marsit. Aktualisht, farmacit e rrjetit të hapur duhet t'i referojnë pacientët nën hetim tek autoritetet e tyre lokale ose kombëtare të shëndetit, në mënyrë që të dinë se ku t'i drejtohen pacientët për të dy mostrat nazofaringeal dhe testin diagnostikues COVID-19 (SARS-COV-2).

Disa qeveri, [like in the UK](#), kanë këshilluar kundër përdorimit të testeve të tilla të shpejta në popullatë, përfshirë ato në farmaci, sepse tani nuk ka asnjë provë të publikuar për besueshmërinë dhe përshtatshmërinë e këtyre testeve, për diagnostikimin e infeksionit COVID-19 në një mjedis të popullatës.

Sidoqoftë, për shkak të kapacitetit të kufizuar në disa vende në lidhje me pajisjet mjekësore dhe pajisjet e testimit, disa agjenci rregullatore (si [US Food and Drug Administration](#)) dhe qeveritë (të tilla si në [Spain](#), [China](#), [Italy](#) and [Japan](#)) kanë miratuar dhe / ose blerë teste të shpejta për të zgjeruar kapacitetin diagnostikues të kërkuar gjatë epidemisë.

Pas marrjes së mostrave nazofaringeale (qoftë nga hundët, grykët, dhe / ose nazofaringu) të kryer nga infermierë ose staf mjekësor i kualifikuar, dhe pasi të jenë marrë nga laboratorët klinikë, testet që analizohen zakonisht marrin më pak se gjashtë orë për të dhënë një rezultat, në krahasim me testet e zhvilluara së fundmi që marrin më pak se tre orë.

Rekomandohet të vendosni kritere të renditjes me përparësi për testimin në rast se kërkesa për teste diagnostikuese mund të tejkalojë kapacitetin e laboratoreve, dhe mund të kërkohet rregullimi i kërkesave. Këto rregulla prioritare duhet të vendosen në marrëveshje me, ose pas udhëzimeve të autoriteteve kompetente kombëtare ose rajonale.

Për farmacistët që punojnë në laboratorët e biologjisë klinike që mund të përfshihen në testimin diagnostik të mostrave nga rastet e dyshuara, OBSH ka zhvilluar një udhëzim të përkohshëm që mund të gjendet [here](#).

Stafi klinik i laboratorit, për shkak të ekspozimit të tyre të drejtpërdrejtë ndaj pacientëve të mundshëm, edhe nëse asimptomatik, gjatë marrjes së mostrës së gjakut ose ndonjë lëngu tjetër biologjik, duhet të bëjë çdo përpjekje për të mbrojtur veten nga infektimi duke ndjekur rekomandimet e autoriteteve të tyre shëndetësore kombëtare (duke veshur maska kirurgjikale dhe rekomandime të tjera).

Laboratorët klinikë duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm për të dërguar, ose ofruar udhëzime të duhura për praktikuesit klinikë për dërgimin e mostrave në laboratorët e zgjedhur të vendeve të tyre, dhe të pyesin rreth tyre tek autoritetet kombëtare kompetente. OBSH mund të ndihmojë shtetet anëtare në identifikimin e laboratorëve të aftë për të siguruar këtë mbështetje. Të gjitha mostrat për testimin e COVID-19 duhet të paketohen dhe transportohen në përputhje me [United Nations Category B model regulations for transportation](#). Paketimi I UN 3373 duhet të përdoret për transportin e mostrave.

Udhëzime shtesë mund të gjenden në faqen e internetit të Qendrave të SHBA për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve [Interim Guidelines for Collecting, Handling, and Testing Clinical Specimens from Persons for Coronavirus Disease 2019 \(COVID-19\)](#). (Centers for Disease Control and Prevention, 2020).

Sigurimi i stokut dhe aksesit për barnat dhe pajisjet kryesore

Duke synuar parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së COVID-19, farmacistë duhet të garantojnë furnizimin e barnave, përfshirë ato të përdorura për parandalimin e sëmundjeve, diagnozën dhe trajtimin, si dhe për furnizimin me ekipe ndihmëse mjekësore.

Farmacistë duhet të caktojnë një farmacist që të marrë përsipër blerjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e barnave kryesore, dhe të rregullojë inventarin sipas nevojës për të garantuar furnizimin për praktikën klinike.

Lista përfshin barna antivirale, agentë antimikrobikë, antipiretikë, analgjezikë.

Dhe në spitale, kortikosteroide dhe disa kategori të tjera të barnave. Furnizim me pajisje (përfshirë termometrat, maska, dhe në spitale, sendet e tjera të pajisjeve mbrojtëse (p.sh., respiratorë, dorezat dhe syze) duhet të jenë të siguruar në mënyrë adekuate.

Shihni Udhëzimet e FIP "COVID-19: Informacione klinike dhe udhëzime për trajtimin" (në dispozicion në www.fip.org/coronavirus) dhe tabela e zhvilluar nga Shoqata Farmaceutike Kineze në [Annex 1](#). Për një listë të pajisjeve kryesore, dhe pajisjeve mbrojtëse personale, të zhvilluara gjithashtu nga Shoqata Kineze Farmaceutike, shihni [Annex 2](#).

Në situata të karantinimit në shtëpi të pacientëve, farmacitë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e furnizimit me barna përmes dërgesave në shtëpi, jo vetëm për trajtimin e COVID-19, por edhe të sëmundjeve të tjera kronike apo akute.

Menaxhimi i pastrimit dhe dezinfektimit

Për shkak se COVID-19 mund të transmetohet përmes spërklave dhe kontaktit fizik, çdo zonë e spitalit ose e mjedisit në farmaci që mund të jetë ndotur duhet të dezinfektohet vazhdimisht. Studimet e mëparshme mbi SARS CoV dhe MERS-CoV sugjerojnë që SARS-CoV-2 është i ndjeshëm ndaj rrezatimit ultravjollcë (UVC) dhe nxehtësisë (56°C për 30 minuta) (Cinatl J Rabenau HF, 2005). Gjithashtu, dezinfektuesit e mëposhtëm mund të çaktivizojnë në mënyrë efektive SARS-CoV-2: eter, 75% etanol, dezinfektues që përmbajnë klor, acid peracetik dhe kloroform. Klorheksidina nuk mund të çaktivizojë në mënyrë efektive SARS-CoV-2.

Kampf dhe bashkëpunëtorët e tij kanë konstatuar gjithashtu nga analiza e 22 studimeve që koronaviruset njerëzore si koronavirusi SARS apo MERS ose koronaviruset endemike të njeriut (HCoV) mund të qëndrojnë në sipërfaqe të pajeta si metali, qelqi ose plastike, deri në nëntë ditë, por mund të çaktivizohet në mënyrë efikase nga procedurat e dezinfektimit sipërfaqësor me etanol (në 62-71%), 0% peroksid hidrogjeni ose 0.1% hypoklorite natriumi brenda një minute. (Kampf G, 2020)

Dëshmi të reja nga studimet me SARS-CoV-2 (Neeltje van Doremalen, 2020), arritën në përfundimin se virusi mbetet i qëndrueshëm dhe efektiv në materiale të ndryshme deri në 72 orë, sipas tabelës më poshtë:

Lloji i sipërfaqes / aerosolit	Qëndrueshmëria	Gjysëm-jeta
Aerosol	Deri në 3 orë	1.1-1.2 orë
Çelik inox	Nga 48-72 orë	5.6 orë
Karton/letër	Deri në 24 orë	3.46 orë
Plastikë	Deri në 72 orë	6.8 orë
Bakër	Deri në 4 orë	0.7 orë

Këto gjetje i bëjnë jehonë atyre me SARS-CoV-1, në të cilat këto forma të transmetimit u shoqëruan me ngjarje super-përhapëse, dhe ato japin informacione për përpjekjet për zbutjen e pandemisë. (Neeltje van Doremalen, 2020)

Stafi i farmacisë duhet të pastrojë dhe dezinfektojë mjedisin e punës, dhe artikuj dhe pajisje të tjera në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret përkatëse të pastrimit dhe dezinfektimit. (Chinese Pharmaceutical Association, 2020)

Për një listë të dezinfektuesve dhe aplikimin e tyre në objekte të kontaminuara, shihni [Annex 4](#).

Për më tepër, CDC-të e Shteteve të Bashkuara kanë publikuar [guidance](#) (udhëzime) me rekomandime të hollësishme për pastrimin dhe dezinfektimin e shtëpive ku qëndrojnë persona të cilën dyshohet se mund të jenë infektuar ose dihet që kanë COVID-19. Udhëzimi ka për qëllim kufizimin e mbijetesës së virusit në mjedise të ndryshme. Ky dokument përcakton një dallim midis pastrimit dhe dezinfektimit:

- **Pastrimi** i referohet heqjes së mikrobeve dhe papastërtive nga sipërfaqet. Pastrimi

nuk vret mikrobet, por duke i hequr ato, ul numrin e tyre dhe rrezikun e përhapjes së infeksionit.

- **Dezinfektimi** i referohet përdorimit të kimikateve për të vrarë mikrobet në sipërfaqe. Ky proces nuk pastron domosdoshmërisht sipërfaqet ose largon mikrobet, por duke vrarë mikrobet në një sipërfaqe pas pastrimit, mund të ulë më tej rrezikun e përhapjes së infeksionit. (Centers for Disease Control and Prevention, 2020)

Kontrolli i infeksionit : masa paraprake të tjera

1. Higjiena e frymëmarrjes duhet të praktikohet nga të gjithë, veçanërisht personat e sëmurë, në çdo kohë. Higjiena e frymëmarrjes i referohet mbulimit të gojës dhe hundës gjatë kollitjes ose teshtimës duke përdorur maska mjekësore, shami, facoleta ose një bërryl të përkulur, i ndjekur nga procesi i higjenizimit të duarve.
2. Hidhni materialet e përdorura për të mbuluar gojën ose hundën ose pastrojini ato siç duhet pas përdorimit (p.sh. lani shaminë duke përdorur sapun të rregullt ose pastrues dhe ujë).
3. Shmangni kontaktin e drejtpërdrejtë me lëngjet trupore, veçanërisht sekrecionet e gojës ose të frymëmarrjes dhe jashtëqitjen. Përdorni doreza një përdorimëshe dhe syze për të siguruar kujdesin e gojës ose të frymëmarrjes dhe kur trajtoni jashtëqitje, urinë dhe mbeturina. Kryeni procesin e higjenizimit të duarve para dhe pas heqjes së dorezave.
4. Doreza, facoleta, maska dhe mbetje të tjera të krijuara nga persona të sëmurë ose nga personat që kujdesen për individë të sëmurë duhet të vendosen në një enë të posaçme në dhomën e personit të sëmurë përpara se të bashkohen me mbeturina të tjera shtëpiake.
5. Shmangni llojet e tjera të ekspozimit të mundshëm ndaj personave të sëmurë ose sendeve të kontaminuara në mjedisin e tyre (p.sh. shmangni gotën e furçave të dhëmbëve, cigareve, enëve të ngrënies, pjatave, pijeve, peshqirëve, rrobave ose çarçafëve). Enët e ngrënies dhe pjatat duhet të pastrohen me sapun ose pastrues dhe ujë pas përdorimit dhe mund të përdoren përsëri. Kjo vlen edhe për syzet.
6. Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet e prekura shpesh, siç janë mobiljet e krevateve, dysheqet dhe orenditë e tjera të dhomës së gjumit çdo ditë me dezinfektues shtëpiak që përmban zbardhues (1 pjesë zbardhues në 99 pjesë ujë).
7. Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet e banjës dhe tualetit të paktën një herë në ditë me dezinfektues shtëpiak që përmban zbardhues (1 pjesë zbardhues në 99 pjesë ujë). Popullata duhet të kryejë procesin e higjenizimit siç duhet dhe shpesh, veçanërisht pas përdorimit të tualetit (ulja e kapakut të tualetit poshtë para se të shkarkoni për të shmangur përhapjen e mikrobeve). (Centre for Health Protection Hong Kong, 2020)
8. Pastroni rrobat, çarçafët, peshqirët e banjës dhe të duarve të personave të sëmurë duke përdorur sapun të rregullt lavanderie dhe ujë ose lavatrice në 60-90°C me pastrues të zakonshëm shtëpiak dhe thajeni tërësisht. Vendosni veshje të kontaminuar në një qese rrobash. Mos tundni rrobat e ndotura. Qeveritë mund të marrin në konsideratë masa për të siguruar që mbeturinat të depozitohen në një depo sanitare, dhe jo në një depo të hapur të pa monitoruar, kur është e mundur. Mund të nevojiten masa shtesë për të parandaluar ripërdorimin johigjienik të dorezave dhe maskave, dhe për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë të lëkurës dhe rrobave me materialet e kontaminuara.
9. Përdorni doreza një përdorimëshe, syze dhe veshje mbrojtëse (p.sh. platforma plastike) kur pastroni sipërfaqe, veshmbathje ose zona me lëngje trupore. Kryeni procesin e higjenizimit të duarve para dhe pas heqjes së dorezave. (World Health

Organization, 2020)

Një tjetër dokument i dobishëm për t'u shqyrtuar për udhëzime të përgjithshme në parandalimin dhe kontrollin e përhapjeve të sëmundjeve të respiratore është përgatitur nga OBSH dhe është në dispozicion [here](#). (World Health Organization, 2014)

Kontrolli i infeksionit : larja dhe fërkimi i duarve

Farmacitë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në shëndetin publik duke rritur ndërgjegjësimin në lidhje me rëndësinë e larjes së shpeshtë dhe të përshtatshme të duarve dhe duke depozituar ose përgatitur dezinfektuesin e duarve me bazë alkooli.

Higjiena e duarve është thelbësore për parandalimin e përhapjes së virusit, dhe duhet të kryhet duke aplikuar teknikat [correct technique recommended by the WHO](#) dhe duke përdorur ose sapun dhe ujë të rrjedhshëm ose një dezinfektues me bazë alkooli.

OBSH rekomandon që formulimet të kenë një përmbajtje alkooli prej 80% etanol ose 75% alkool izopropil.

Si të përgatisim produkte me bazë alkooli për dezinfektimin e duarve

Për informacion të detajuar se si të përgatisni formulimet, duke përfshirë metodat e llogaritjes dhe formulimit dhe një udhëzues hap pas hapi për prodhuesit vendorë, referojuni Udhëzuesit të OBSH-së për Prodhimin Lokal: Formulimet e fërkimit të duarve të rekomanduara nga OBSH, të cilat ne i shfaqim ne këtë [Annex 3](#).

Dokumenti është gjithashtu në dispozicion në:

https://www.who.int/gpsc/5may/Guide_to_Local_Production.pdf

Farmacia si një burim informacioni

Farmacistët dhe shoqatat e tyre mund të krijojnë materiale informative (posterë, fletëpalosje, faqe në internet, mesazhe me tekst, njoftime për aplikacione, etj) për komunitetin, përfshirë informacionin që përmbahet në këto udhëzime dhe çdo informacion tjetër që mund të jetë i rëndësishëm për nevojat lokale. Ata gjithashtu mund të organizojnë seanca me pyetje dhe përgjigje në popullatë (shkolla, qendra komunitare, etj.).

FIP gjithashtu ka zhvilluar një poster të vogël për t'u fotokopjuar dhe shpërndarë me këshilla kryesore që farmacistët mund të ofrojnë në një varg skenarësh të ndryshëm.

FIP gjithashtu zhvilloi një faqe në internet ku mund të arrihen këto materiale dhe burime të tjera. Ju lutemi vizitoni www.fip.org/coronavirus në mënyrë të vazhdueshme për përditësime. Përveç materialeve FIP në gjuhë të ndryshme, kjo faqe në interneti përmban dokumente udhëzuese të hartuara nga Shoqata Kineze Farmaceutike në anglisht dhe në gjuhën kineze.

Përveç këtyre burimeve, mund të gjeni një përmbledhje të gjerë ndërkombëtare të burimeve të komunikimit në internet në gjuhë të ndryshme, të listuara në këtë seksion [Other resources and information](#).

Adresimi i problemeve të udhëtimit

Njerëzit mund të shqetësohen për mundësinë e udhëtimit në të njëjtin aeroplan, anije, autobus ose automjet tjetër me një person të infektuar me COVID-19, dhe mund të pyesin në farmaci për këtë.

Ndërsa transmetimi i virusit COVID-19 ka ardhur duke u rritur në të gjithë botën, popullata këshillohet që të konsiderojë vonimin e të gjithë udhëtimeve jo thelbësore.

Publiku duhet të marrë parasysh këshillat shëndetësore më poshtë kur udhëton:

1. Shmangni udhëtimet në çdo zonë ku ka një përhapje në popullatë të virusit COVID-19;
2. Kur udhëtoni në vendet / zonat me përhapje të virusit COVID-19, shmangni kontaktin fizik me personat me ethe ose simptomat e sipërpërmëndura. Nëse është e pamundur të mos kontaktoni me ta, vendosni një maskë kirurgjikale dhe vazhdoni ta mbani atë deri në 14 ditë pas kthimit në vendin tuaj;
3. Shmangni vizitat në spitale. Nëse është e nevojshme të vizitoni një spital, vishni një maskë kirurgjikale dhe kryeni vazhdimisht procesin e higjienizimit personal dhe të dorës;
4. Shmangni prekjën e kafshëve (grabitqare) si shpendët dhe sekrecionet e tyre;
5. Shmangni vizitat në tregjet e kafshëve, shpendëve dhe fermat;
6. Mos konsumoni mishin e kafshëve grabitqare dhe mos vizitoni ambientet e ushqimit ku shërbehet mishi i grabitqarëve;
7. Respektoni rregullat e sigurisë ushqimore dhe higjienës, siç janë shmangia e konsumimit të produkteve shtazore të papjekura mire, përfshirë qumështin, vezët dhe mishin, ose ushqimet të cilat mund të jenë të kontaminuara nga sekrecionet e kafshëve, (si urina) ose produktet e kontaminuara, përveç nëse ato janë larë pastruar dhe gatuar siç duhet;
8. Nëse nuk ndjeheni mirë kur udhëtoni, veçanërisht nëse keni ethe ose kollë, vishni maskë kirurgjikale, informoni stafin e hotelit ose guiden e agjencisë dhe kërkonit asistencë mjekësore menjëherë; dhe
9. Pasi të ktheheni në vendin tuaj, këshillohuni menjëherë me një profesionist nëse përjetoni ethe ose simptoma të tjera, merrni iniciativën për t'i informuar ata për çdo histori të udhëtimit dhe çdo ekspozim ndaj kafshëve, vishni një maskë kirurgjikale për të ndihmuar në parandalimin e përhapjes së sëmundjes .

Është e dobishme të kujtoni njerëzit se përhapja e COVID-19 nga personi në person ndodh kryesisht përmes spërklave të frymëmarrjes të prodhuara kur një person i infektuar kollitet ose teshtin, të ngjashme me atë se si përhapen gripi dhe patogenët e tjerë sëmundjeve respiratore. Si e tillë, kjo mund të ndodhë gjatë udhëtimit. Duhet patur parasysh vetë-disiplinimi për të shmangur çdo kontakt me lëkurën dhe të përmbahen nga prekja e fytyrës.

Kështu që, nëse një person ka ethe dhe kollë, duhet të këshillohet të shmangë udhëtimet.

Disa vende janë duke marrë masa për të kufizuar udhëtimin ose për të kontrolluar pasagjerët në aeroporte dhe porte me qëllim zbulimin e udhëtarëve simptomatikë për vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm, dhe të parandalojnë eksportimin e sëmundjes duke minimizuar përhapjen në trafikun ndërkombëtar.

Ekzaminimi përfshin: kontrollimin e shenjave dhe simptomave (ethe, temperature mbi 38°C, kollë); intervistimi i udhëtarëve me simptoma të infeksionit që vijnë nga zonat e prekura; drejtimi i udhëtarëve simptomatikë në ekzaminim të mëtejshëm mjekësor i ndjekur nga testimi për SARS-CoV-2; dhe mbajtja e rasteve të konfirmuara nën izolim dhe trajtim. (World Health Organization, 2020)

Bibliografia

Associação Nacional das Farmácias de Portugal. (2020). *Portuguese community pharmacies: Preventive and security good practices for COVID-19*. Lisbon: ANF.

Centers for Disease Control and Prevention. (06 de March de 2020). *Environmental cleaning and Desinfection Recommendations. Interim recommendations for US Households with Suspected/confirmed Coronaviruses Disease 2019*. Fonte: Centers for Disease Control and Prevention: <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/community/home/cleaning-disinfection.html>

Centers for Disease Control and Prevention. (7 de March de 2020). *Interim Clinical Guidance for Management of Patients with Confirmed Coronavirus Disease (COVID-19)*. Fonte: <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/hcp/clinical-guidance-management-patients.html>

Centers for Disease Control and Prevention. (31 de January de 2020). *Interim Guidance for Healthcare Professionals*. Acesso em 1 de February de 2020, disponível em CDC - 2019 Novel Coronavirus: <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-nCoV/hcp/clinical-criteria.html#foot1>

Centers for Disease Control and Prevention. (10 de March de 2020). *Interim Infection Prevention and Control Recommendations for Patients with Suspected or Confirmed Coronavirus Disease 2019 (COVID-19) in Healthcare Settings*. Fonte: https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/infection-control/control-recommendations.html?CDC_AA_refVal=https%3A%2F%2Fwww.cdc.gov%2Fcoronavirus%2F2019-ncov%2Fhcp%2Finfection-control.html

Centers for Disease Control and Prevention. (2020). *Three Key Factors Required for a Respirator to be Effective*. Fonte: <https://www.cdc.gov/niosh/npptl/pdfs/KeyFactorsRequiredResp01042018-508.pdf>

Centre for Health Protection Hong Kong. (2020). *Frequently Asked Questions on Coronavirus Disease 2019 (COVID-19)*. Fonte: <https://www.chp.gov.hk/en/features/102624.html>

Centro de Informação do Medicamento - CEDIME Portugal. (2020). *Plano de contingência COVID-19 - Farmácia*. Lisbon: CEDIME.

Chinese Pharmaceutical Association. (2020). *Coronavirus SARS-CoV-2 Infection: Expert Consensus on Guidance and Prevention Strategies for Hospital Pharmacists and the Pharmacy Workforce (2nd Edition)*. Beijing: Chinese Pharmaceutical Association.

Cinatl J Rabenau HF, M. B. (2005). Stability and inactivation of SARS coronavirus[J]. *Med Microbiol Immunol*, 194((1-2)), 1-6. Fonte: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/15118911>

Federfarma. (12 de March de 2020). *Emergenza coronavirus e consegna farmaci a domicilio, iniziativa Croce Rossa Italiana in collaborazione con Federfarma*. Fonte: Federfarma.it: <https://www.federfarma.it/Edicola/Filodiretto/VediNotizia.aspx?id=20996>

Ghebreyesus, T. A. (16 de March de 2020). *WHO Director-General's opening remarks at the media briefing on COVID-19 - 16 March 2020*. Fonte: World Health Organization: <https://www.who.int/dg/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19---16-march-2020>

INFARMED - Autoridade Nacional do Medicamento e Produtos de Saúde. (2020). *Orientações técnicas para farmácias no âmbito da pandemia COVID-19*. Lisbon: INFARMED.

Kampf G, T. D. (2020). Persistence of coronaviruses on inanimate surfaces and its inactivation with biocidal agents. *J Hosp Infect*. doi:<https://doi.org/10.1016/j.jhin.2020.01.022>

Neeltje van Doremalen, D. H.-S. (17 de March de 2020). Aerosol and Surface Stability of SARS-CoV-2 as Compared with SARS-CoV-1. *New England Journal of Medicine*. Fonte: <https://www.nejm.org/doi/10.1056/NEJMc2004973>

Ruiyun Li, S. P. (16 de March de 2020). Substantial undocumented infection facilitates the rapid dissemination of novel coronavirus (SARS-CoV2). *Science*. doi:10.1126/science.abb3221

Shuo Feng, C. S. (20 de March de 2020). Rational use of face masks in the COVID-19 pandemic. *The Lancet*. Fonte:

<https://www.thelancet.com/action/showPdf?pii=S2213-2600%2820%2930134-X>

US Department of Labor - Occupational Safety and Health Administration. (2020). *Guidance on Preparing Workplaces for COVID-19*. Fonte: <https://www.osha.gov/Publications/OSHA3990.pdf>

World Health Organization. (2009). *Natural Ventilation for Infection Control in Health-Care Settings*. Fonte: https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK143284/pdf/Bookshelf_NBK143284.pdf

World Health Organization. (April de 2010). *Guide to Local Production: WHO-recommended Handrub Formulations*. Fonte: https://www.who.int/gpsc/5may/Guide_to_Local_Production.pdf

World Health Organization. (2014). *Infection prevention and control of epidemic-and pandemic-prone acute respiratory infections in health care. WHO Guidelines*. Fonte: https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/112656/9789241507134_eng.pdf?sequence=1

World Health Organization. (28 de January de 2020). *Advice on the use of masks in the community, during home care and in health care settings in the context of the novel coronavirus (2019-nCoV) outbreak*. Fonte: [https://www.who.int/publications-detail/advice-on-the-use-of-masks-the-community-during-home-care-and-in-health-care-settings-in-the-context-of-the-novel-coronavirus-\(2019-ncov\)-outbreak](https://www.who.int/publications-detail/advice-on-the-use-of-masks-the-community-during-home-care-and-in-health-care-settings-in-the-context-of-the-novel-coronavirus-(2019-ncov)-outbreak)

World Health Organization. (2020). *Coronavirus disease (COVID-19) advice for the public: When and how to use masks*. Fonte: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/advice-for-public/when-and-how-to-use-masks>

World Health Organization. (20 de January de 2020). *Home care for patients with suspected novel coronavirus (nCoV) infection presenting with mild symptoms and management of contacts*. Fonte: [https://www.who.int/publications-detail/home-care-for-patients-with-suspected-novel-coronavirus-\(ncov\)-infection-presenting-with-mild-symptoms-and-management-of-contacts](https://www.who.int/publications-detail/home-care-for-patients-with-suspected-novel-coronavirus-(ncov)-infection-presenting-with-mild-symptoms-and-management-of-contacts)

World Health Organization. (24 de January de 2020). *Updated WHO advice for international traffic in relation to the outbreak of the novel coronavirus 2019-nCoV*. Fonte: https://www.who.int/ith/2019-nCoV_advice_for_international_traffic/en/

World Health Organization. (25 de January de 2020). *Infection prevention and control during health care when novel coronavirus (nCoV) infection is suspected: interim guidance*. Fonte: [https://www.who.int/publications-detail/infection-prevention-and-control-during-health-care-when-novel-coronavirus-\(ncov\)-infection-is-suspected-20200125](https://www.who.int/publications-detail/infection-prevention-and-control-during-health-care-when-novel-coronavirus-(ncov)-infection-is-suspected-20200125)

SHTOJCA 1: Lista e barnave kryesore për trajtimin e COVID-19

Kjo listë u përpilua nga Shoqata Farmaceutike Kineze, përveç paracetamolit, i cili u shtua nga FIP. Për arsyetimin dhe referencat mbështetëse për secilën mundësi terapeutike, konsultohuni me dokumentin original (në anglisht), të disponueshëm në faqen e dedikuar për FIP.(Chinese Pharmaceutical Association, 2020) Shënim: Kjo listë është vetëm për referencë, institucioni mjekësor mund të bëjë rregullime sipas kushteve të tyre specifike.

Tipi i trajtimit	Emri i barit	Forma e dozimit dhe specififikimet
Trajtimi antiviral	Interferoni rekombinant njerëzor	Interferoni rekombinant human α -2a Injeksion: 3 milion IU, 5 milion IU; Interferon rekombinant human α -2b injeksion, Interferoni rekombinant human α -2b Injeksion (P.putida): 3 milion IU, 5 milion IU
	Lopinavir/ritonavir	Kapsulë : lopinavir 200mg, ritonavir 50mg
	Ribavirin	Injeksion: 1ml: 0.1g
Agjentët antimikrobik	Sipas listës ekzistuese të barnave të institucionit mjekësor	
Trajtimi me analgjezik dhe antipiretik	Ibuprofen	Tabletë, Granula: 0.1g, 0.2g ; Kapsula: 0.2g ; Çlirim të ngadaltë (tabletë, kapsulë) 0.3g ; Pezulli : 60mL: 1.2g, 100mL: 2g
	Paracetamol / acetaminophen	Deri në 4gr në ditë
	Sipas listës ekzistuese të barnave të institucionit mjekësor	
Kortikosteroidët <i>(kur është rreptësisht e nevojshme, sipas vlerësimit mjekësor të pacientëve individualë, kryesisht në ambiente spitalore)</i>	Methylprednisolone	Tabletë: 4mg (Sodium succinate) pluhur steril për injeksion : 40mg, 500mg
Preparate per floren intestinale	Sipas listës ekzistuese të barnave të institucionit mjekësor	
Trajtim tjetër gastrointestinal	Sipas listës ekzistuese të barnave të institucionit mjekësor	
Trajtim antitusiv	Sipas listës ekzistuese të barnave të institucionit mjekësor	
Trajtimi i heqjes së pështymës	Sipas listës ekzistuese të barnave të institucionit mjekësor	
Trajtimi anti- astmatik	Sipas listës ekzistuese të barnave të institucionit mjekësor	
Barna patentë kinezë	Huoxiangzhengqi	Kapsulë e butë: 0.45g; Pilula per perdorim me pika: 2.6g / qese Pilula e koncentruar: 8 pika te pilulave janë ekuivalente me 3g preparat bimor Tretësirë: 10ml ; Solucion oral: 10mL
	Jinhua Qinggan	Granulat: 5g (Ekuivalente me 17.3g preparat bimor)
	LianhuaQingwen	Kapsulë: 0.35g; Granule: 6g/bag
	ShufengJiedu	Kapsulë: 0.52g
	Fangfengtongsheng	Pilula të përqendruara: 8 pilula ekuivalente me 6g preparat bimore; Pilula qe treten: 6g / qese Granulat: 3g / qese
	Xiyanping	Injeksion : 2ml:50mg,5ml:125mg
	Xuebijing	Injeksion : 10ml
	Shenfu	Injeksion : 10ml
	Shengmai	Injeksion: 10ml, 20ml

SHTOJCA 2: Lista e pajisjeve kryesore dhe mjeteve mbrojtëse personale ndaj infeksioneve SARS-CoV-2

Kjo listë u përpilua nga Shoqata Farmaceutike Kineze. Është i zbatueshëm veçanërisht për ambientet e farmacisë spitalore. Për më shumë detaje, konsultohuni me dokumentin origjinal (në anglisht), i disponueshëm në faqen e dedikuar FIP. (Shoqata Farmaceutike Kineze, 2020 (12 Shkurt))

Classification		Emër
Facilitete	Thelbësor	Pika e shpërndarjes së barnave e izoluar (mbrojtëse xhami)
	Fakultativ	Kabineti i sigurisë biologjike
Pajisje	Thelbësor	Llambë UV
		Sterilizues ajri
		Pajisjet për matjen e temperaturës së trupit
		High-pressure steam steriliser
		Kutia e transferimit
	Fakultativ	Pajisjet inteligjente të shpërndarjes
Pajisje për Mbrojtje personale	Thelbësor	Maskë mbrojtëse mjekësore
		Kapuc pune me një përdorim
		Doreza një përdorimeshe
		Veshje mbuluese
	Fakultativ	Maska kirurgjikale mjekësore
		Maska mbrojtëse mjekësore (maskë N95 ose maskë ekuivalente)
		Mburojat e fytyrës
		Ventilator për furnizimin me ajër me pompe ose filtër pluhuri opsional
		Syze
		Doreza gome të trasha me mëngë të gjata
		Këpucë pune
		Çizme gome
		Mbështjellëse e çizmeve e papërshkueshme nga uji
		Mbështjellëse e këpucëve e disponueshme
		Veshje mjekësore
		Rrip i papërshkueshëm nga uji
		Veshje izoluese e papërshkueshme nga uji

SHTOJCA 3: Udhëzuesi i OBSH-së për prodhimin lokal të formulimeve të higjenës së duarve

Source: [Guide to Local Production: WHO-recommended Handrub Formulations](#) (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2010)

Materialet e kërkuara (prodhim i vëllimit të vogël)

REAGENTET PER FORMULIM 1::	REAGENTET PER FORMULIMI 2:
<ul style="list-style-type: none"> • Etanol 96% • Peroksidi i hidrogjenit 3% • Glicerine 98% • Ujë të ftohtë të zjerë Steril ose te distiluar 	<ul style="list-style-type: none"> • Alkool izopropil 99.8% • Peroksidi i hidrogjenit 3% • Glicerinë 98% • Ujë të ftohtë të zjerë Steril ose te distiluar

- Shishe qelqi ose plastike 10-litra me vidhosje (1), ose
- Tanke plastike 50 litra (preferohen prej polipropileni ose polietileni me densitet të lartë, i tejdukshëm në mënyrë që të shihet niveli i lëngut) (2), ose
- Rezervuarë prej çeliku inox me një kapacitet prej 80-100 litra (për përzierje pa rrjedhje) (3, 4)
- Llamba prej druri, plastike ose metali për përzierje (5)
- Cilindra matës dhe kana matëse (6, 7)
- Gyp plastik ose metal
- 100 ml shishe plastike me maja të papërshkueshme (8)
- Shishe 500 ml qelqi ose plastike me majë te vidhoshme (8)
- Një mates alkooli: shkalla e temperaturës është në fund dhe përqendrimi i etanolit (përqindja v / v) në krye (9, 10, 11)

SHËNIM

- Glicerina: përdoret si ruajtës i humiditetit, por emolientë të tjerë mund të përdoren për kujdesin e lëkurës, me kusht që ato të jenë të lira, të disponueshme dhe që shpërhapen në ujë dhe alkool dhe të mos shtojnë toksicitetin apo të promovojnë alergji.
- Peroksidi i hidrogjenit: përdoret për të çaktivizuar sporet bakteriale kontaminuese në tretësirë dhe nuk është një substancë aktive antiseptike e duarve.
- Aditivet shtesë për të dy formulimet duhet të etiketohen qartë dhe të jenë jo toksik në rast të gëlltitjes aksidentale.
- Një ngjyrues mund të shtohet për të lejuar diferencimin nga lëngjet e tjera, por nuk duhet të shtojë toksicitetin, të promovojë alergji ose të ndërhyjë në vetitë antimikrobiale. Shtimi i parfumeve ose ngjyrave nuk rekomandohet për shkak të rrezikut të reaksioneve alergjike.



METODA: PËRGATITJE 10-litra

Shishet e qelqit dhjetë litërshe ose plastike, me ndalesa të ndërprera me vidhosje, janë të përshtatshme.

Sasitë e rekomanduara të produkteve:

FORMULIMI 1	FORMULIMI 2
<ul style="list-style-type: none">• Etanol 96%: 8333 ml• Peroksidi i hidrogjenit 3%: 417 ml• Glicerine 98%: 145 ml	<ul style="list-style-type: none">• Alkool izopropili 99.8%: 7515 ml• Peroksidi i hidrogjenit 3%: 417 ml• Glicerine 98%: 145 ml

Përgatitja hap pas hapi:



1. Alkooli për formulën që do të përdoret hidhet në shishen e madhe ose rezervuarin deri në shenjë.



4. Shishja / rezervuari derdhet më pas në enën 10-litërshe me ujë të distiluar ose të zjerë dhe të ftohur.



2. Peroksidi i hidrogjenit shtohet duke përdorur një cilindër matës



5. Kapaku me vidhosje i vihet rezervuarit/ shishes sa më shpejt të jetë e mundur pas përgatitjes, në mënyrë që të parandalohet avullimi.



3. Glicerina shtohet duke përdorur një cilindër matës. Meqenëse glicerina është shumë viskoze dhe ngjitet në murin e cilindrit matës, duhet të shpëlahet me pak ujë të distiluar ose të ftohtë të zjerë dhe më pas të zbrazet në shishe / rezervuar.



6. Tretësira përzihet duke tundur lehtësisht aty ku është e mundur ose duke përdorur një përzjerës.

7. Ndajeni menjëherë solucionin në enët e saj përfundimtare (p.sh. shishe plastike 500 ose 100 ml) dhe vendosni shishet në karantinë për 72 orë para përdorimit. Kjo lejon kohën që çdo spore e pranishme në alkool ose shishet e reja/të ripërdorura të shkatërrohen.

Produkti final

FORMULIMI 1	FORMULIMI 2
Përqendrimet përfundimtare:: <ul style="list-style-type: none">• Etanol 80% (v/v),• Glicerine 1.45% (v/v),• Peroksid hidrogjeni 0.125% (v/v)	• Përqendrimet përfundimtare: <ul style="list-style-type: none">• Alkool izopropil 75% (v/v)• Glicerinë 1.45% (v/v),• Peroksid hidrogjeni 0.125% (v/v)


Kontrolli i cilësisë

1. Analiza e para-prodhimit duhet të bëhet çdo herë që një certifikatë analize nuk është në dispozicion për të garantuar titrimin e alkoolit (psh. prodhimi vendas). Verifikoni përqendrimin e alkoolit me alkool meter dhe bëni rregullimet e nevojshme në vëllim në formulimin e përgatitjes për të marrë përqendrimin e rekomanduar përfundimtar

2. Analiza pas prodhimit

është e detyrueshme nëse përdoret etanol apo një solucion izopropanoli. Përdorni alkool metrin për të kontrolluar përqendrimin e alkoolit në solucionin përfundimtar. Kufijtë e pranuar duhet të rregullohen në 5% të përqendrimit të synuar (75% - 85% për etanol). concentration (75%– 85% for ethanol

3. Alkool- metri i treguar në këtë pamflet është për përdorim me etanol; nëse përdoret për të kontrolluar një solucion izopropanol, një solucion 75% do të tregojë 77% ($\pm 1\%$) në shkallë në 25 ° C.



Informacion i përgjithshëm

Etiketimi duhet të jetë në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe duhet të përfshijë sa vijon:

- Emri i institucionit
- Formulimi i rekomanduar nga OBSH për produktin e higjenes se duarve
- Vetëm për përdorim të jashtëm
- Shmangni kontaktin me sytë
- Mbajini larg fëmijëve
- Data e prodhimit dhe numri i serisë

- Përdorimi: Aplikoni një sasi të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë sipërfaqet e duarve. Fërkoni duart derisa të thahen

- Përbërja: etanol ose izopropanol, glicerinë dhe peroksid hidrogjeni

- Të ndezshme: mbajini larg flakës dhe nxehtësisë

Ambjentet e prodhimit dhe të ruajtjes:

- Ambjentet e prodhimit dhe ruajtjes në mënyrë ideale duhet të jenë dhoma me ajër të kondicionuar ose të ftohtë. Asnjë flakë apo pirja e duhanit nuk duhet të lejohet në këto zona.

- Formulimet e higjenzuesve të duarve të rekomanduara nga OBSH nuk duhet të prodhohen në sasi që tejkalojnë 50 litra në vend ose në farmacitë qendrore që kanë mungesë të kondicionimit dhe ventilimit të specializuar.

- Meqenëse etanoli i patretur është shumë i ndezshëm dhe mund të ndizet në temperatura të ulëta deri në 10 ° C, ai duhet të hollohet direkt në përqendrimin e sipërpërmendur. Pikat e ndezjes të etanolit 80% (v / v) dhe të alkoolit izopropil 75% (v / v) janë 17.5 ° C dhe 19 ° C, përkatësisht

- Udhëzimet Kombëtare të Sigurisë dhe kërkesat ligjore vendore duhet të respektohen në ruajtjen e përbërësve dhe produktin përfundimtar.

SHTOJCA 4: Qëndrueshmëria e SARS-CoV-2 në aerosole dhe sipërfaqe të ndryshme, dhe lista e dezinfektuesve për objektet e kontaminuara zakonisht

Lloji i sipërfaqes / aerosolit	Qëndrueshmëria	Gjysëm-jeta
Aerosol	Deri në 3 orë	1.1-1.2 orë
Çelik inox	Nga 48-72 orë	5.6 orë
Karton/letër	Deri në 24 orë	3.46 orë
Plastikë	Deri në 72 orë	6.8 orë
Bakër	Deri në 4 orë	0.7 orë

Burim: (Neeltje van Doremalen, 2020)

Lista e mëposhtme u përpilua nga Shoqata Farmaceutike Kineze. Për më shumë detaje, konsultohuni me dokumentin original (në anglisht), i disponueshëm në faqen e dedikuar FIP. (Chinese Pharmaceutical Association, 2020)

Objekti për dezinfektim	Lloji i dezinfektuesit	Të konsumueshëm
Sipërfaqja e objektit mjedisor	Dezinfektues që përmban klor (1000mg / L), dioksid klori (500mg / L), alkool 75%	Material absorbues i disponueshëm
Duar	Dezinfektues të tharjes së shpejtë të alkoolit, dezinfektues që përmban klor, peroksid hidrogjeni,	
Lëkurë	0.5% dezinfektues me bazë jodi, peroksidi i hidrogjenit	
Mukozë	Dezinfektues me bazë jodi 0,05%	
Ajër i brëndshëm	Acidi peracetik, dioksidi i klorit, peroksidi i hidrogjenit	
Ndotësi	Dezinfektues që përmban klor (5000-20000mg / L), pluhur dezinfektues ose pluhur zbardhues që përmban thithjen e ujit	
Tekstile të tilla si rroba, shtrati	Dezinfektues që përmban klor (500mg / L, oksid etileni	
Recetat	Oksidi i etilenit	

Vlefshmëria

Ky dokument fillimisht u përgatit në bazë të provave ekzistuese që nga 5 shkurt 2020. Ai u përditësua në lidhje me nomenklaturën e virusit dhe sëmundjes më 12 shkurt 2020, dhe u azhurnua përsëri në 26 Mars 2020 sipas provave të reja në dispozicion.

Mohim

Ky dokument bazohet në provat në dispozicion dhe rekomandimet e organizatave me reputacion si Organizata Botërore e Shëndetit, Shtetet e Bashkuara dhe Qendrat Evropiane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, dhe të tjerët, të cituara në kohën e botimit. Njohuritë e disponueshme për COVID-19 po ndryshojnë me shpejtësi dhe rekomandimet e tilla mund të ndryshojnë në përputhje me rrethanat. Edhe pse FIP do të përpiqet t'i mbajë këto udhëzime të azhurnuara, ne ju rekomandojmë të këshilloheni me uebfaqet e këtyre organizatave dhe çdo dëshmi të re të disponueshme për azhurnimet më të fundit.

Mirënjohje

FIP i shpreh mirënjohjen grupit të taskforcës që përpiluan këtë dokument:

Kryetari: **Jane Dawson**, FPS – Seksioni i Farmacisë Ushtarake dhe të Emergjencës së FIP, Zelanda e Re

Marwan Akel, Universiteti Ndërkombëtar Liban, Liban

Julien Fonsart, Presidenti i Seksionit të Biologjisë Klinike të FIP, Francë

Scarlett Pong, Shoqata Farmaceutke e Hong Kong-ut

Eduardo Savio, Shoqata Uruguiane e Kimisë dhe Farmacisë, Uruguai

Lars-Åke Söderlund, Presidenti i Seksionit të Farmacive të Rrjetit të Hapur, Suedi

Gonçalo Sousa Pinto, Udhëheqësi i FIP për Zhvillimin e Praktikës dhe Transformimin

Jacqueline Surugue, Zëvendës President i FIP, Farmacist Spitalor, Francë

Zhao Rongsheng, Spitali i Tretë i Universitetit të Pekinit, Departamenti i Farmacisë; Nënkryetari i Komitetit të Farmacive Spitalore të Shoqatës Kineze Farmaceutike; Nënkryetari i Komitetit të Farmacive të bazuara në Evidenca pjesë e Shoqatës Kineze Farmaceutike, Kinë



International Pharmaceutical Federation (FIP)

Andries Bickerweg 5

2517 JP The Hague

The Netherlands

Tel.: +31-70-3021970

Fax: +31-70-3021999

Email: fip@fip.org

www.fip.org/coronavirus

E përditësuar më 26 Mars 2020



Ky dokument është përkthyer nga anglishtja nga Orion JUCJA, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë. Në rast të ndonjë divergjence midis dy teksteve, dokumenti origjinal i Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike në anglisht prevalon. E drejta e autorit mbetet ajo e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike.